

20130130484

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM TË
DETYRUESHEM PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin për sigurim të detyrueshem pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/10, 171/10, 36/11 dhe 98/12) në nenin 1 paragrafi (2) pas fjalës "instrumente" lidheza "dhe" zevendesohet me presje, kurse pas fjalës "mjete" shtohen fjalet: "dhe të kryejne pagesa të terheqjeve të programuara".

Neni 2

Në nenin 3 paragrafi (1) pas pikes 5 shtohen dy pika të reja 5-a dhe 5-b, si vijojne:

"5-a. "Anetar i pensionuar" është personi fizik i cili ka realizuar të drejte të pensionit nga sigurimi i detyrueshem pensional me financim kapital permes terheqjeve të programuara dhe ka llogari individuale në fondin e detyrueshem pensional dhe nga e cila kryen terheqje të mjeteve.

5-b. "Aktuar i autorizuar" është personi fizik i cili ka leje për pune si aktuar i autorizuar nga Agjencia për supervizion të sigurimit."

Pika 7 ndryshohet si vijon:

"Agjent" është personi i cili kryen pune të marketingut të fondeve pensionale;". .

Në pikën 12 nenpika g) lidheza "dhe" në fund të fjalise zevendesohet me pikepresje.

Në pikën 13 pika në fund të fjalise zevendesohet me lidhezen "dhe".

Pas pikes 13 shtohet pike e re 14, si vijon:

"14) "Pune të marketingut" janë të gjitha aktivitetet qellimi i të cilave është reklamimi i shoqerise për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale dhe të fondit të detyrueshem pensional dhe informimi dhe lidhjs e marreveshjeve për anetaresim në fondit e detyrueshem pensional dhe për pagese të mjeteve nga fondi i detyrueshem pensional që perfshin:

a) reklamim të punës së shoqerise dhe fondit të detyrueshem pensional me të cilin ajo menaxhon;

b) informim për karakteristikat e sigurimit të detyrueshem pensional me financim kapital;

v) informim për kompensimet dhe provizionet transaksionale;

g) informim për të ardhurat e fondit të detyrueshem pensional;

d) informim për portofolin investues të fondit të detyrueshem pensional;

gj) informim për llogarite individuale;

e) anetarsim dhe kalim të anetareve nga një fond në fond tjetër të detyrueshem pensional;

zh) lidhje të marreveshjeve për terheqje të programuara dhe

z) aktivitete tjera për reklamim dhe sigurim të informatave të lidhura me punën e shoqerise dhe të fondit të detyrueshem pensional."

Neni 3

Në nenin 4 paragrafet (2) dhe (3) ndryshohen si vijojne:

"(2)Agjencia e percakton menyren e menaxhimit të mire korporativ të shoqerise."

(3)Shoqeria detyrohet të miratoje kodeks për menaxhim të mire korporativ në pajtim me rregullen nga paragrafi (2) i ketij neni."

Neni 4

Në nenin 18 paragrafi (1) fjalet: "perkatesisht drejtor i pergjithshem ose drejtor" zevendesohen me fjalet: "dhe person udheheqes", ndersa fjalet: "drejtor i pergjithshem ose drejtor" zevendesohen me fjalet: "person udheheqes".

Neni 5

Pas nenit 18 shtohen dy nene të reja 18-a dhe 18-b, si vijojne:

"Neni 18-a

(1) Anetar i bordit drejtues, i bordit mbikeqyres, personi udheheqes në shoqeri dhe organ të shoqerise ka detyre fiduciare të punoje vetem në dobi të interesave të anetareve dhe të anetareve të pensionuar të fondit të detyrueshem pensional. Detyren duhet ta kryeje me zbatim të standardeve të larta të etikes dhe integritetit dhe pa konflikt të interesave dhe të siguroje zbatim të tyre nga çdo i punesuar dhe i angazhuar me pune në shoqeri.

(2) Anetari i bordit drejtues, i bordit mbikeqyres dhe personi pergjegjes në shoqeri duhet të kete kompetence perkatese menaxhuese dhe operative për kryerjen e detyrave të cilat i jane ndare dhe gjithmone të informohet për ceshtjet të cilat kane të bejne me fusheveprimin e tij të punes.

Neni 18-b

(1) Shoqeria detyrohet të vendose mekanizma kontrollues efikas të cilat jane dokumentuar në aktet e tyre interne me qellim të uljes së rreziqeve të cilat ndikojne në interesat e anetareve dhe anetareve të pensionuar të fondit të detyrueshem pensional.

(2) Shoqeria detyrohet të vendose procedure dhe të caktoje persona për ndjekje dhe sigurim të harmonizimit të punes me ligjin, aktet nenligjore dhe aktet interne të shoqerise."

Neni 6

Në nenin 19 paragrafi (1) pas fjales "anetaret" shtohen fjalet: "dhe anetaret e pensionuar".

Neni 7

Në nenin 21 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Shoqeria apo shoqeria për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare detyrohet të mbaje evidence të plote, të sakte dhe të azhurnuar për llogarine individuale të çdo anetari dhe anetari të pensionuar të fondit të detyrueshem pensional, për kontributetet e tij të paguara dhe të bartura, numrin e njesive të kontabilitetit të llogarise dhe vleren e llogarise, si dhe të dhena tjera të percaktuara me ligj."

Në paragrafin (2) pika a) pas fjales "anetaret" shtohen fjalet: "edhe për anetaret e pensionuar", ndersa pas fjales "anetare" shtohen fjalet: "edhe për anetare të pensionuar".

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

"(3) Shoqeria apo shoqeria për menaxhim me fondet pensionale vullnetare dhe të detyrueshme detyrohet ta ruaje evidencen me të gjitha të dhenat e permbajtura në llogarite dhe nenllogarite individuale, në baze të informatave me gjendjen nga dita e fundit e punes të çdo viti kalendarik edhe në medium të jashtem."

Paragrafet (3) dhe (4) behen paragrafe (4) dhe (5).

Në paragrafin (5) i cili behet paragraf (6) numri "(3)" zevendesohet me numrin "(4)".

Paragrafi (6) behet paragraf (7).

Neni 8

Në nenin 21-a paragrafi (2) pika e) lidheza "dhe" zevendesohet me pikepresje.

Në pikën zh) pika në fund të fjalise zevendesohet me pikepresje.

Pas pikes zh) shtohen dy pika të reja z) dhe x), si vijojne:

"z) vleresim të procesit të pagesave nepermjet terheqjeve të programuara dhe

x) vleresim të procesit të menaxhimit me rreziqe."

Neni 9

Pas nenit 21-a shtohen dy nene të reja 21-b dhe 21-v, si vijojne:

"Neni 21-b

(1) Shoqeria detyrohet që të caktojë aktuar të autorizuar i cili për punën e tij përgjigjet para bordit drejtues të shoqërisë.

(2) Nëse aktuari i autorizuar e ndërpret kryerjen e punëve të aktuarit në shoqëri, shoqëria detyrohet që për këtë ta njoftojë Agjencinë në afat prej pesë ditësh nga ndërprerja.

(3) Shoqëria detyrohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e ndërprerjes së kryerjes së punës të aktuarit të autorizuar të emerojë aktuar të ri të autorizuar.

(4) Shoqëria nuk guxon të emerojë aktuar të autorizuar i cili është person i lidhur me shoqërinë në pajtim me këtë ligj.

(5) Aktuari i autorizuar detyrohet që të japë udhëzime për perlllogaritje të terheqjeve të programuara dhe të kontrollojë nëse perlllogaritjet e bera dhe tabelat e shfrytëzuara të vdekshmerisë dhe shkallet e kamates janë perlllogaritur në pajtim me ligjin dhe aktet nenligjore të percaktuara nga Agjencia.

(6) Aktuari i autorizuar detyrohet që të kryejë kontroll të likuiditetit të fondit të detyrueshem pensional.

(7) Çdo tremujor aktuari i autorizuar përpilon vertetim me mendim për veprimet e ndërmarra nga paragrafi (5) dhe (6) të këtij neni, në mënyrë, përmbajtje dhe formë të percaktuara nga Agjencia.

(8) Aktuari i autorizuar vertetimin me mendim nga paragrafi (7) i këtij neni e parashtron në Bordin Drejtues të shoqërisë.

(9) Aktuari i autorizuar përpilon raport për punën e tij për vitin paraprak dhe e dorëzon për miratim në bordin mbikëqyres të shoqërisë.

(10) Nëse aktuari i autorizuar gjatë kryerjes së punës së tij konstaton se terheqjet e programuara nuk janë perlllogaritur në pajtim me ligjin dhe aktet nenligjore të percaktuara nga Agjencia, ai detyrohet që menjëherë ta njoftojë bordin drejtues të shoqërisë. Nëse bordi drejtues nuk e merr parasysh njoftimin e aktuarit të autorizuar, ai detyrohet që menjëherë ta njoftojë Agjencinë.

Neni 21-v

(1) Shoqëria detyrohet të vendosë aktivitete për menaxhim me rreziqe të fondit të detyrueshem pensional.

(2) Shoqëria detyrohet që të emerojë person përgjegjës për menaxhim me rreziqe, i cili duhet të ketë kualifikime adekuate për kryerjen e aktiviteteve të lidhura me menaxhim me rreziqe dhe të mos ketë konflikt të interesave.

(3) Personi nga paragrafi (2) i këtij neni, duhet të ketë qasje në të dhënat në shoqëri. Personi detyrohet që të sigurojë analize objektive të rreziqeve dhe në mënyrë të drejtë ta keshillojë bordin drejtues gjatë miratimit të vendimeve, duke i pasur parasysh të gjitha rreziqet relevante.

(4) Personi nga paragrafi (2) i këtij neni, parashtron raport në bordin drejtues të shoqërisë.

(5) Raportin nga paragrafi (4) i këtij neni, shoqëria detyrohet ta dorëzojë në Agjencinë, së paku njëherë në vit, përkatësisht menjëherë nëse konstatohet se është krijuar kërcënim serioz për interesat e anetareve dhe të anetareve të pensionuar."

Neni 10

Pas nenin 22-a shtohet nen i ri 22-b, si vijon:

"Neni 22-b

Shoqëria detyrohet të japë, mbajë, evidentojë, arkivojë, dorëzojë, publikojë njoftime, të dhëna, informata të sakta dhe të azhurnuara."

Neni 11

Në nenin 39-v paragrafi (1) pika x) ndryshohet si vijon:

"të dhenat për persona të cilet do të jene në vende udheheqese dhe persona tjere të cilet propozohet që të jene përgjegjes për vendime investuese, menaxhim me rreziqe, revizion të brendshëm, llogari individuale, marketing, kontroll të agjenteve dhe perlllogaritje të terheqjeve të programuara;"

Në pikën k) lidheza "dhe" në fund të fjalise zevendesohet me pikepresje.

Në pikën ll) pika në fund të fjalise zevendesohet me lidhezen "dhe"

Pas pikës ll) shtohet pike e re l), si vijon:

"l) deklarate të nenshkruar, nga nenshkrues të autorizuar të të gjithë personave të cilet jane themelues, se pas marrjes së lejes për menaxhim me fondin e detyrueshem pensional shoqeria do të perfshihet në Qendren për sistem elektronik për kotacion (në tekstin e metejme: Qendra), në pajtim me Ligjin për pagese të pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga sigurimi pensional me financim kapital dhe".

Neni 12

Në nenin 39-g pas fjales "anetaresohen" shtohen fjalet: "ose behen anetare të pensionuar".

Në pikën d) pas fjales "anetareve" shtohen fjalet: "dhe të anetareve të pensionuar".

Në pikën e) pas fjales "anetaret" shtohen fjalet: "dhe anetaret e pensionuar", ndersa pas fjales "anetare" shtohen fjalet: "ose anetare të pensionuar".

Neni 13

Në nenin 39-e pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

"(5) Shoqeria detyrohet që në afat prej 90 ditesh nga dita e plotfuqishmerise së lejes për menaxhim me fondin e detyrueshem pensional në pajtim me paragrafin (2) të ketij neni të perfshihet në Qendren në pajtim me Ligjin për pagese të pensioneve dhe kompensimeve pensionale të sigurimit pensional me financim kapital."

Paragrafi (5) behet paragraf (6).

Neni 14

Në nenin 39-z paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Agjencia mund të terheq ose shfuqizojë leje për menaxhim me fondin e detyrueshem pensional për shkaqet e njejta për të cilat refuzon kerkese për shkak të mosdorezimit të dokumenteve nga neni 39-v i ketij ligji, mosplotesimit të kushteve nga nenet 39-g dhe 39-e paragrafi (5) të ketij ligji, keqperdorimi i të dhenave për të siguruarit e sistemuar perkohesisht, anetaret apo anetaret e pensionuar, me kerkese të shoqerise ose shoqerise për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, shkelje e ashper e dispozitave të ketij ligji dhe në raste tjera të percaktuara me kete ligj."

Në paragrafin (2) pas fjales "anetareve" shtohen fjalet: "dhe anetareve të pensionuar".

Neni 15

Ne nenin 39-x paragrafi (2) pas fjales "anetareve" shtohen fjalet: "dhe anetareve të pensionuar".

Në paragrafin (3) pas fjales "anetaret" shtohen fjalet: "dhe anetaret e pensionuar".

Neni 16

Ne nenin 39-j paragrafi (5) pika i) ndryshohet si vijon:

"të dhena për persona të cilet do të jene në vende udheheqese dhe persona tjere të cilet propozohet që të jene përgjegjes për vendime investuese, menaxhim me rreziqe, revizion të brendshëm, llogari individuale, marketing, kontroll të agjenteve dhe perlllogaritje të terheqjeve të programuara;

Ne piken j) lidheza "dhe" zevendesohet me pikepresje.

Pas pikes j) shtohet pike e re k) si vijon:

"k) deklarate të nenshkruar, nga nenshkrues të autorizuar të shoqerive që bashkohen, se pas marrjes së lejes për menaxhim me fondin e detyrueshem pensional do të perfshihet në Qendren në pajtim me Ligjin për pagese të pensioneve dhe kompensimeve pensionale të sigurimit pensional me financim kapital dhe".

Pika k) behet pike ll).

Neni 17

Në nenin 39-k në piken a) pas numrit "21-a" shtohet presje dhe numrat "21-b, 21-v".

Në pikat g) dhe d) pas fjales "anetareve" shtohen fjalet: "dhe anetareve të pensionuar".

Neni 18

Ne nenin 39-l pas fjales "anetaret" shtohen fjalet: "dhe anetaret e pensionuar".

Neni 19

Në nenin 39-m paragrafi (3) pas fjales "anetaret" shtohen fjalet: "dhe anetaret e pensionuar".

Në paragrafin (4) pas fjales "anetaret" shtohet presje dhe fjalet: "anetaret e pensionuar".

Neni 20

Në nenin 40 paragrafi (1) fjalia e dyte ndryshohet si vijon: "Fondin e detyrueshem pensional e formojne kontributet dhe mjetet e anetareve, mjetet e anetareve të pensionuar dhe të ardhurat nga kontributet dhe mjetet e investuara, të zvogeluara për kompensimet që arketohen nga fondi i detyrueshem pensional."

Në paragrafin (2) pas fjales "anetaret" shtohen fjalet: "dhe anetaret e pensionuar".

Neni 21

Në nenin 45 paragrafi (1) pika b) pas fjales "anetaret" shtohen fjalet: "dhe anetaret e pensionuar".

Në piken d) pas fjales "anetaret" shtohen fjalet: "dhe anetaret e pensionuar" dhe lidheza "dhe" në fund të fjalise zevendesohet me pikepresje.

Pas pikes d) shtohet pike e re gj) si vijon:

"gj) të dhenat për menyren e perlllogaritjes dhe pageses së terheqjeve të programuara dhe".

Pika gj) behet pike e).

Neni 22

Në nenin 46 paragrafi (7) pas fjales "anetareve" shtohen fjalet: "dhe anetareve të pensionuar".

Neni 23

Në nenin 47 paragrafi (1) pika d) "anetareve" shtohen fjalet: "dhe anetareve të pensionuar".

Në piken (zh) pas fjales "anetareve" shtohen fjalet: "dhe regjister të anetareve të pensionuar".

Neni 24

Në nenin 48 pas fjales "anetareve" shtohen fjalet: "dhe anetareve të pensionuar".

Neni 25

Në nenin 49 paragrafi (1) pas fjales "anetaret" shtohen fjalet: "dhe anetaret e pensionuar".

Ne paragrafin (2) pas fjales "anetare" shtohen fjalet: "dhe anetare të pensionuar", pas fjales "anetari" shtohen fjalet: "ose anetari i pensionuar", ndersa pas fjales "anetar" fjalet "si anetar i fondit të detyrueshem dhe/ose vullnetar" shlyhen.

Neni 26

Në nenin 53 paragrafi (1) pas pikes v) shtohet pike e re -g), si vijon:
"g) t'i marre për shikim të gjitha dokumentet dhe evidencen elektronike të Qendres si dhe informatat nga drejtori i saj lidhur me aktivitetet e Qendres";

Pika g) behet pike d).

Në piken d) e cila behet pike gj) fjalet: "pika g)" zevendesohen me fjalet: "pikat g) dhe d)".

Në paragrafin (2) në piken v) pika në fund të fjalise zevendesohet me lidhezen "dhe".

Pas pikes v) shtohet pike e re g), si vijon:

"g) Qendra për shikim dhe kontroll të ligjshmerise së punes."

Në paragrafin (5) pas fjales "mjete" shtohet presje dhe fjalet: "të Qendres".

Neni 27

Në nenin 53-b paragrafi (1) pas fjales "mjete" shtohet presje dhe fjalet: "të Qendres".

Neni 28

Pas nenit 53-b shtohet nen i ri 53-v, si vijon:

"Neni 53-v

(1) Agjencia ndermerr masa dhe cakton afate për zbatim të tyre, nese shoqeria pensionale, rojtari i prones, organi i menaxhimit apo mbikeqyrjes apo personi pergjegjes i shoqerise pensional nuk i respekton rregullat dhe/ose aktet interne me të cilat rregullohet puna e shoqerise pensionale dhe menaxhimi i tyre me mjetet e fondeve pensionale.

(2) Agjencia ndermerr masa të ndara në grupet si vijojne:

a) Grupi i pare: zbatimi i edukimit, trajnimit, rekomandimit, sugjerimit dhe paralajmerimit;

b) Grupi i dyte: miratimi i aktvendimit për menjanim të paligjshmerise, barazim dhe ngritje të procedures për kundervajtje dhe

v) Grupi i trete: heqja e lejes anetarit të bordit drejtues dhe shoqerise pensionale.

(3) Gjate vendimmarrjes se cilen mase do ta ndermarre, Agjencia udhëhiqet nga:

a) demi potencial dhe gjasa për shkaktim të paligjshmerise dhe/ose parregullsise, perkatesisht rreziku nga shkaktimi i tyre, si dhe ndikimi i tyre mbi stabilitetin dhe sigurine e shoqerive pensionale, fondeve pensionale dhe sistemit pensional në teresi;

b) ndikimi ose ndikimi potencial i masave të shoqerise pensionale apo fondit pensional në drejtim të parandalimit të perkeqesimit të metutjeshem të gjendjes në shoqerine pensionale apo fondin pensional;

v) nese paligjshmeria, perkatesisht parregullsia ka qene e qellimshme dhe nese perseritet dhe

g) gatishmeria e organeve të shoqerise pensionale për menjanim të paligjshmerive dhe/apo parregullsive të konstatuara.

Neni 29

Në nenin 55 paragrafi (3) pika v) pas fjales "anetarit" shtohen fjalet: "dhe anetarit të pensionuar", ndersa pas fjales "prones" shtohet presje dhe fjalet: "së Qendres".

Në piken g) lidheza "ose" zevendesohet me presje, ndersa pas fjales "anetari" shtohen fjalet: "ose nga anetari i pensionuar".

Neni 30

Në nenin 58 paragrafi (1) numri "131" zevendesohet me numrin "118".

Neni 31

Neni 61 ndryshohet si vijon:

"(1) Anetari i fondit të detyrueshem pensional mund të kaloje dhe të anetaresohet në fond tjeter të detyrueshem pensional.

(2) Anetari i cili ka llogari individuale në fondin e detyrueshem pensional (fondi i detyrueshem pensional ekzistues) mund të behet anetar i fondit të detyrueshem pensional i menaxhuar nga shoqeri tjetër (fondi i detyrueshem pensional i ardhshëm), me nenshkrim të marreveshjes për kalim me shoqerine që menaxhon me fondin e detyrueshem pensional të ardhshëm në pajtim me nenin 59 të këtij ligji, nenshkrim të deklarates për pelqim për kalim të verifikuar në noter dhe pagim të kompensimit në pajtim me nenin 98 paragrafi (1) pika v) të këtij ligji.

(3) Shoqeria që menaxhon me fondin e detyrueshem pensional të ardhshëm detyrohet të beje kontroll nese jane plotesuar kushtet nga paragrafi (2) i këtij neni dhe ta regjistroje anetarin në Regjistrin e anetareve.

(4) Anetaresimi në fondin e detyrueshem pensional të ardhshëm fillon në datën e parë të ardhshme për bartjen e mjeteve.

(5) Agjencia e percakton permbajtjen e marreveshjes për kalim në fondin e detyrueshem pensional dhe deklarates për pelqim për kalim në fondin e detyrueshem pensional."

Neni 32

Në nenin 64-a pika b) fjalet: "131 paragrafi (2)" zevendesohen me fjalet: "118 paragrafi (2)".

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Agjencia mund ta anulose regjistrimin e anetarit të pensionuar të fondit të detyrueshem pensional në regjistrin e anetareve të pensionuar nese:

a) regjistrimi eshte bazuar në të dhena të pasakta;

b) në baze të vendimit gjyqesor ose

v) në raste tjera që nuk janë në përputhje me rregullat që e rregullojnë sigurim pensional dhe invalidor dhe sigurimin pensional me financim kapital."

Neni 33

Në nenin 65 paragrafi (1) numri "132-v" zevendesohet me numrin "122".

Në paragrafin (4) numri "139" zevendesohet me numrin "130".

Neni 34

Në nenin 66-a paragrafi (1) fjalet: "131 paragrafi (2)" zevendesohen me fjalet: "118 paragrafi (2)".

Neni 35

Në nenin 67 paragrafi (4) pas fjales "ligj" shtohet presje dhe fjalet: "si dhe për mjetet e llogarise individuale të anetarit të pensionuar".

Neni 36

Në nenin 74 paragrafi (1) pas fjales "anetaresohet" shtohen fjalet: "apo të lidhe marreveshje për terheqje të programuara", ndersa pas fjales "anetar" shtohen fjalet: "apo anetar i pensionuar".

Paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

"Dhurate, sipas këtij neni do të thote, por nuk kufizohet në shperblime me para, pagesa e kompensimit me para për nderprerje të parakohshme të anetaresimit apo prishje të marreveshjes për terheqje të programuara nga fondi tjetër i detyrueshem pensional, dhurimi i sendeve të tundshme dhe të patundshme, veprave artistike, organizimi i ekspozitave apo shfaqjeve, apo veprime tjera të cilat zakonisht duhet të paguhen, pervec atyre pagesave që drejtperdrejte dalin nga të drejtat e anetareve dhe anetareve të pensionuar të fondit të detyrueshem pensional."

Neni 37

Në nenin 75 paragrafi (1) pas fjales "anetareve" shtohen fjalet: "dhe anetareve të pensionuar", kurse pas fjales "anetare" shtohen fjalet: "dhe anetare të pensionuar".

Në paragrafin (2) pas fjales "anetareve" shtohen fjalet: "dhe anetareve të pensionuar", kurse pas fjales "anetaresohen" shtohen fjalet: "apo të lidhin marreveshje për terheqje të programuara".

Neni 38

Në nenin 76 paragrafi (2) shtohet fjali e ri si vijon: "Shoqeria apo shoqeria për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale detyrohet me bashkepunetorin afarist të lidhe marreveshje për kryerje të puneve të marketingut të fondit të detyrueshem pensional në lokalet e bashkepunetorit afarist."

Neni 39

Në nenin 77 paragrafi (1) pas fjales "anetaresim" shtohet presje, ndersa fjalet: "apo marreveshje të perkohshme për anetaresim" zevendesohen me fjalet: "marreveshje për kalim apo marreveshje për terheqje të programuara".

Në nenin (2) pas fjales "anetaresim" shtohet presje, ndersa fjalet: "apo të marreveshjes për perkohshme për anetaresim në fondin e detyrueshem pensional" zevendesohen me fjalet: "të marreveshjes për kalim apo të marreveshjes për terheqje të programuara".

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Pune të marketingut të fondeve të detyrueshme pensionale mund të kryeje personi pas regjistrimit të tij në regjistrin e agjenteve. Agjenti detyrohet që të gjitha kontaktet me anetarin, me anetarin e pensionuar apo me personat që kane të drejte të behen anetare apo të lidhin marreveshje për terheqje të programuara t'i kryeje personalisht dhe nuk guxon të lidhe marreveshje permes personit tjetër."

Neni 40

Në nenin 78 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Nese i punesuari, perfaqesuesi, agjenti apo personi i lidhur i shoqerise apo shoqeria për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale ndikon mbi anetarin apo mbi anetarin e pensionuar që ta nderpreje marreveshjen me shoqerine tjetër apo shoqerine për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe të lidhe marreveshje me shoqerine që e perfaqeson apo prezanton, doemos duhet t'u jape prioritet interesave të atij anetari kundrejt interesave personale apo interesave të shoqerise."

Neni 41

Në nenet 81 paragrafi (1) dhe 83 paragrafi (2) pas fjales "anetareve" shtohen fjalet: "dhe anetareve të pensionuar".

Neni 42

Në nenin 82 paragrafi (4) pas fjales "anetari" shtohen fjalet: "edhe anetarit të pensionuar".

Neni 43

Në nenin 85 paragrafi (3) pas fjales "fondet" shtohet presje dhe fjalet: "ndersa i verteton rojtari i prones".

Në paragrafin (4) pas fjales "anetareve" shtohen fjalet: "dhe anetareve të pensionuar".

Neni 44

Neni 86 ndryshohet si vijon:

"(1) Shoqeria që menaxhon me fondin e detyrueshem pensional detyrohet, në fund të qershorit dhe dhjetorit çdo vit, t'i percaktoje të ardhurat në shume nominale dhe reale për 84 muajt paraprake në pajtim me paragrafin (2) të ketij neni. Nese fondi i detyrueshem pensional nuk ka pranuar kontribute në periudhe prej 84 muajsh, por ka pranuar në periudhe prej 12 muajsh, në

fund të qershorit perkatesisht dhjetorit, do të percaktohen të ardhurat për periudhen nga qershori i pare perkatesisht dhjetori pas themelimit të fondit në fund të qershorit perkatesisht dhjetorit kur behet perlllogaritja. Të dhenat për të ardhurat shoqeria i dergon në Agjenci.

(2) Të ardhurat e fondit të detyrueshem pensional në shume nominale jane të barabarta me ndryshimin e vleres së njesise së kontabilitetit në daten e fundit të vleresimit nga paragrafi (1) i ketij neni lidhur me vleren e njesise së kontabilitetit në daten e fundit të vleresimit nga muaji fillestar nga paragrafi (1) i ketij neni. Të ardhurat e fondit të detyrueshem pensional në shume reale perlllogariten në baze të të ardhurave të fondit të detyrueshem pensional në shume nominale dhe nivelit të shpenzimeve për jetese në periudhen e njejte për të cilen perlllogariten të dhenat, të publikuara nga Enti Shtetëror për Statistike i Republikës së Maqedonisë. Shuma e të ardhurave shprehet në perqindje.”

Neni 45

Në nenin 89 paragrafi (1) pika a) fjalet: "institucion i autorizuar i posacem" zevendesohen me fjalet: "shoqeria për sigurim e autorizuar".

Në piken b) fjalet: "ku ai ka qene anetar në ditën e pensionimit" zevendesohen me fjalet: "me të cilin anetari do të lidhe marreveshje për terheqje të programuara".

Neni 46

Neni 90 ndryshohet si vijon:

"(1) Nese pensioni i perlllogaritur i anetarit të fondit të detyrueshem pensional eshte më i madh apo i barabarte me shumën e nevojshme për pagese të pensionit invalidor në pajtim me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor, anetari i fondit të detyrueshem pensional mund në vend të atij pensioni invalidor, të zgjedh lloj të pageses nga neni 89 i ketij ligji.

(2) Nese pensioni i perlllogaritur i anetarit të fondit të detyrueshem pensional eshte më i madh apo i barabarte me shumën e nevojshme për pagese të pensionit familjar në pajtim me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor, shfrytezues i pensionit familjar mund në vend të atij pensioni familjar, të zgjedh lloj të pageses nga neni 89 i ketij ligji."

Neni 47

Neni 91 ndryshohet si vijon:

"Procedura për krahasim me shumën e pensioneve nga neni 90 i ketij ligji behet në pajtim me Ligjin për pagese të pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve nga sigurimi pensional me financim kapital."

Neni 48

Në nenin 93 fjala "ligj" zevendesohet me fjalet: "Ligjin për pagese të pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve nga sigurimi pensional me financim kapital".

Neni 49

Në nenin 94 paragrafi (1) fjalia e dyte ndryshohet si vijon: "Prospekti informativ permban të dhena të plota, të sakta dhe objektive për fondin e detyrueshem pensional dhe shoqerine që menaxhon me atë fond, që jane të nevojshme që anetari potencial të marre vendim për anetaresim në fondin e detyrueshem pensional dhe anetari i pensionuar potencial të lidhe marreveshje për terheqje të programuara si vijon:".

Në piken zh) pas fjales "anetaret" shtohen fjalet "edhe nga anetaret e pensionuar".

Pika z) ndryshohet si vijon:

"menyren e anetaresimit, lidhjes së marreveshjes për terheqje të programuara dhe marreveshje për kalim;".

Ne piken x) pas fjales "anetareve" shtohen fjalet: "dhe anetareve të pensionuar".

Në piken k) pas fjales "anetareve" shtohen fjalet: "dhe anetaret e pensionuar".

Në paragrafin (4) pas fjales "anetar" shtohen fjalet: "ose nga anetari i pensionuar", ndersa pas fjales "anetaresim" shtohen fjalet: "ose deshiron të lidhe marreveshje për terheqje të programuara".

Neni 50

Në nenin 95 në paragrafin (3) shtohet fjali e re si vijon: "Ky njoftim, pas pelqimit paraprak me shkrim nga anetari, në vend të formes me shkrim mund të dorezohet edhe në forme elektronike."

Pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6) si vijon:

"(6) Dispozitat nga paragrafet (1), (2), (3), (4) dhe (5) të ketij neni në menyre perkatese zbatohen edhe për anetaret e pensionuar."

Neni 51

Neni 96 ndryshohet si vijon:

"(1) Shoqeria apo shoqeria për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale detyrohet që Agjencise t'ia dorezoje informatat në vijim:

a) raporte financiare tremujore të pareviduara dhe raporte vjetore të pareviduara dhe të reviduara për shoqerine bashke me bilancin bruto;

b) raportet financiare themelore të pareviduara tremujore dhe raportet plotesuese dhe raportet financiare të pareviduara dhe të reviduara dhe raportet plotesuese për fondin e detyrueshem pensional bashke me bruto bilancin;

v) të dhena të hollesishme për marrjen dhe bartjen e mjeteve të fondit të detyrueshem pensional me theksimin e çdo mjeti veç e veç, daten dhe cmimin e transaksionit dhe personin juridik i cili e kryen sherbimin me letrat me vlere.

g) të dhena për shpenzimet për Agjencine, rojtarin e prones, transaksionet, marketingun, agjentet dhe shpenzimet tjera në pajtim me kete ligj;

d) të dhena të aksionareve të shoqerise duke i perfshire emrat dhe adresat;

gj) emrat e anetareve të organeve drejtuese dhe të punesuarve në shoqeri dhe lartesine e kompensimeve për punen e tyre;

e) informate për njoftime të dorezuara për anetaret dhe për anetaret e pensionuar nga neni 95 paragrafet (1) dhe (3) të ketij ligji;

zh) të dhena më të hollesishme për numrin e pergjithshem të anetareve të fondit të detyrueshem pensional, numrin e anetareve të cilet jane anetaresuar në fondin e detyrueshem pensional; numrin e atyre që kane kaluar në fond tjetër të detyrueshem pensional, numrin e anetareve të vdekur dhe numrin e shfrytezuesve të pensionit;

z) të dhena më të hollesishme për numrin e pergjithshem të anetareve të pensionuar në fondin e detyrueshem pensional, numrin e personave të cilet kane lidhur marreveshje për terheqje të programuara dhe kombinim sipas llojit të pageses, numrin e anetareve të pensionuar të cilet i kane nderprere marreveshjet për terheqje të programuara dhe kane bere ndryshim të shoqerise e cila kryen pagese të terheqjes së programuar ose llojit të pageses së pensionit, numrin e anetareve të pensionuar të vdekur;

x) evidence nga neni 21 paragrafi (1) i ketij ligji;

i) vertetim me mendim të aktuarit të autorizuar;

j) raport vjetor për punen e aktuarit të autorizuar;

k) llogari për menyren e permbushjes së obligimeve nga nenet 18-a, 18-b dhe 21-v të ketij ligji;

ll) raport për vleresimin e kryer të mjeteve të fondit të detyrueshem pensional;

l) raport nga kontrollet e brendshme dhe revizioneve të brendshme dhe

m) të dhena të tjera të percaktuara nga Agjencia.

(2) Raportet financiare të pareviduara nga paragrafi (1) pikat a) dhe b) të ketij neni, dorezohen në afat prej një muaji pas perfundimit të periudhes me të cilen kane të bejne raportet, ndersa raportet financiare të reviduara nga paragrafi (1) pikat a) dhe b) të ketij neni, dorezohen në afat prej tre muajsh pas perfundimit të periudhes me të cilen kane të beje raportet. Raportet nga paragrafi (1) pikat a) dhe b) të ketij neni, shoqeria apo shoqeria për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale i shpall në ueb faqen e vet në afat prej pese diteve nga dorezimi në Agjenci.

(3) Të dhenat nga paragrafi (1) pikat v) dhe ll) të ketij neni, dorezohen për çdo date të vleresimit më së voni ditën e ardhshme të punes.

(4) Të dhenat nga paragrafi (1) pikat g), zh) dhe z) të ketij neni dorezohen njehere në muaj, më së voni deri në ditën e peste të muajit për muajin paraprak.

(5) Të dhenat nga paragrafi (1) pikat d), gj) dhe k) të ketij neni, dorezohen një here në vit, më së voni deri në ditën e 15-të nga perfundimi i vitit afarist.

(6) Të dhenat nga paragrafi (1) pika e) të ketij neni, dorezohen në afat prej një muaji nga perfundimi i periudhes me të cilen kane të bejne të dhenat.

(7) Raportet nga paragrafi (1) pika l) e ketij neni dorezohen për çdo tremujor, më së voni deri në ditën e peste për tremujorin paraprak.

(8) Vertetimi me mendim nga paragrafi (1) pika i) e ketij neni dorezohet në afat prej një muaji pas perfundimit të periudhes me të cilen ka të beje vertetimi, ndersa raporti nga paragrafi (1) pika j) dorezohet në afat prej tre muajve pas perfundimit të periudhes me të cilen ka të beje raporti.

(9) Evidenca nga paragrafi (1) pika x) e ketij neni dorezohet në afat prej 15 ditesh pas perfundimit të çdo viti kalendarik.

(10) Agjencia më afersisht i percakton llojin dhe periudhen me të cilen kane të bejne të dhenat, menyren dhe formen e paraqitjes së tyre dhe proceduren për dorezimin tyre."

Neni 52

Në nenin 98 paragrafi (1) në piken a) perqindja "4%" zevendesohet me perqindjen "2%".

Pika b) ndryshohet si vijon:

"kompensim mujor nga vlера e neto mjeteve të fondit të detyrueshem pensional, për mbulim të shpenzimeve të shoqerise ose shoqerise për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, për menaxhim me fondin e detyrueshem pensional. Lartesine e kompensimit e percakton shoqeria, por ajo nuk mund të tejkaloje 0,03 % nga vlера neto e mjeteve. Perlllogaritja e kompensimit kryhet në çdo të vleresimit të mjeteve të fondit të detyrueshem pensional dhe arketohet në ditën e peste të punes të muajit pas vleresimit dhe".

Neni 53

Në nenin 100 paragrafi (3) fjalet; "marreveshje e perkoheshme" zevendesohen me fjalet "marreveshje për kalim".

Neni 54

Në nenet 101 paragrafi (2), 109 paragrafi (4), 114, 118 paragrafi (1) dhe 122 paragarfi (3) pas fjales "anetaret" shtohen fjalet: "dhe anetareve të pensionuar".

Neni 55

Neni 102 shlyhet.

Neni 56

Neni 104 ndryshohet si vijon:

"(1) Shoqeria ose shoqeria për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare eshte e obliguar që mjetet për fond të detyrueshem pensional t'i investoje në pajtim me dispozitat e ketij ligji dhe strategjine investuese me qellim të realizimit të kontributit më të larte vetem në dobi të anetareve dhe anetareve të pensionuar të fondit të detyrueshem pensional dhe permes diversifikimit dhe analizes financiare të minimizohet rreziku nga humbjtet:

- 1) të cilat janë shkaktuar nga mospagimi i dhenesit ose pales tjetër kontraktuese;
- 2) të cilat dalin nga ndikimi i tregjeve financiare vendase dhe të huaja;
- 3) në vlerë reale të mjeteve të fondit të detyrueshem pensional për shkak të inflacionit dhe
- 4) të cilat janë pasoje nga shitja e mjeteve të fondit të detyrueshem pensional për sigurimin e likuiditetit të fondit të detyrueshem pensional.

(2) Anetari i Keshillit Drejtues dhe Keshillit Mbikeqyres në shoqeri ose shoqeri për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare gjatë menaxhimit dhe kontrollit të investimit të mjeteve për fonde të detyrueshme pensionale është i obliguar të përgatise shkallen e kujdesit, besueshmerisë dhe shkathtësive të cilat do t'i zbatonte njeriu i matur gjatë investimit të mjeteve personale. Çdo anetar duhet t'i plotesoje obligimet e tij në pajtim me detyren e tij fiduciare dhe duhet të siguroje zbatim të tyre nga çdo i punësuar dhe i angazhuar me punë në shoqeri."

Neni 57

Në nenin 112-a paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Dokumenti për investim strategjik në vecanti duhet t'i përmbaje bazat për analiza të cilat përfshijnë vendosjen e kontributit të planifikuar për fondin e detyrueshem pensional, për periudhën kohore e cila përputhet me periudhën kohore në të cilën një anetar i moshës mesatare të fondit të detyrueshem pensional do të anetaresohet në fond, duke pasur parasysh nivelin e shpenzimeve për jetë, në pajtim me dispozitat e nenit 104 të këtij ligji. Në dokumentin për investime strategjia duhet të theksohet se si do të menaxhohet me rreziqet të cilat janë të lidhura me arritjen e kontributit të planifikuar dhe investimit strategjik të mjeteve, metodat për matjen e rrezikut të investimit, proceset për menaxhim me rreziqe të cilat do të zbatohen që të arrihet kontributi dhe percjelljen e menyrës së realizimit të tij."

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Shoqeria ose shoqeria për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale së paku një herë në vit, për çdo fond pensional me të cilin menaxhon, përgatit dokument për menyrën e zbatimit të strategjisë investuese për 12 muajt e ardhshëm, duke përfshirë investimin në çdo lloj të mjeteve, kufizimet interne për investim dhe ekspozim në rreziqe."

Paragrafi (3) behet paragraf (4).

Neni 58

Në nenin 117 paragrafi (1) pas pikës d) shtohen tri pika të reja gj) e) dhe zh) si vijojnë:

"gj) bën llogari në neto mjete dhe në njesinë e kontabilitetit të fondit të detyrueshem pensional, i kontrollon dhe i verteton llogaritjet të cilat i kryen shoqeria ose shoqeria për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare dhe është përgjegjës për saktësinë e përlogaritjeve;

e) informon për kuvendet vjetore të aksionareve të shoqerive dhe për të drejtat e lidhura me pronësinë dhe i kryen urdheresat lidhur me realizimin e të drejtave të pronësisë;

zh) kryen kontroll të harmonizimit të portofolit të fondit të detyrueshem pensional me investime të kufizuara në pajtim me këto ligj dhe aktet nenligjore;" .

Pikat gj) dhe e) behen pika z) dhe x).

Neni 59

Në nenin 118 paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Në çdo datë të vlerësimit, rojtari i pronës e informon Agjencinë për vlerën e neto mjeteve edhe për njesinë e kontabilitetit të fondit të detyrueshem pensional."

Pas paragrafit (3) shtohen katër paragrafe të rinj (4), (5), (6) dhe (7), si vijojnë:

"(4) Nëse ekziston mospërputhje e llogaritjeve të neto mjeteve në njesinë e kontabilitetit të fondit pensional të detyrueshem të bërë nga shoqeria ose shoqeria për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare edhe nga roja e pronës, shoqeria ose shoqeria për

menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare eshte e obliguar të harmonizohet me llogaritjet e bera nga rojtari i prones. Rojtari i prones menjehere e informon Agjencine për menyren e zgjidhjes së mosharmonizimit.

(5) Nese, pas kontrollit të nenit 117 paragrafi (1) pika zh) të ketij ligji, rojtari i prones, percakton mosharmonizim në portofolin e fondit të detyrueshem pensional menjehere e informon Agjencine.

(6) Rojtari i prones dorezon në Agjenci raport për punen e vet një here në vit deri më 31 janar për vitin paraprak.

(7) Agjencia për së afermi i percakton, periudhen, formen dhe llojin e të dhenave të cilat duhet t'i permbajne raportet e paragrafeve (3), (4), (5) dhe (6) të ketij neni. “

Neni 60

Në nenin 125 paragrafi (5) pas fjales "nene" shtohen fjalet: "edhe të lidh marreveshje të reja për terheqje të programuara".

Në paragrafin (6) pas fjales "anetaret" shtohen fjalet: "edhe anetaret e pensionuar".

Neni 61

Në nenin 126 paragrafi (3) pas fjales "anetaret" shtohen fjalet: "dhe anetaret e pensionuar".

Neni 62

Në nenin 129 pas fjales "anetar" shtohen fjalet: "ose anetarit të pensionuar".

Neni 63

Në nenin 130 paragrafi (1) pas numrit "136-a" lidheza "dhe" zevendesohet me presje, ndersa pas numrit "136-b" vihet presje dhe shtohen numrat "136-gj dhe 136-e".

Neni 64

Në nenin 132 paragrafi (1) pas numrit "136-g" lidheza "dhe" zevendesohet me presje, e pas numrit "136-d" vihet presje dhe shtohen numrat "136-gj dhe 136-e".

Neni 65

Në nenin 133 paragrafi (1) pika 3 pas fjales "anetar" shtohen fjalet: "ose anetarit të pensionuar".

Në piken 4 pas fjales "anetareve" shtohen fjalet: "ose anetareve të pensionuar".

Në piken 6 pas fjales "ligj" shtohen fjalet "dhe aktet e Agjencise."

Në piken 8 pas fjales "standardet" shtohen fjalet: "dhe forma dhe permbajtja e raporteve financiare të percaktuara nga Agjencia";

Pika 11 ndryshohet si vijon:

"investon mjete nga fondi i detyrueshem pensional në kundershtrim me nenet 104, 105, 106, 107 dhe 108 të ketij ligji dhe aktet e percaktuara nga Agjencia";

Në paragrafin (3) pika 3 pas fjales "mban" shtohet presje dhe fjala "llogarit".

Në paragrafin (3) pika 4 numri "(8)" zevendesohet me numrin "(9)".

Pas pikes 9 shtohen dy pika të reja 9-a) dhe 9-b) si vijojne:

"9-a) nuk e ploteson detyren fiduciare nga neni 18-a paragrafi (1) të ketij ligji;

9-b) nuk perfshihet në Qender në pajtim me nenin 39-e paragrafin (5) të ketij ligji;".

Neni 66

Në nenin 134 paragrafi (1) pika 2) pas numrit "(3) shtohet presje ndersa numri "dhe (4)" zevendesohet me numrat "(4) dhe (5)".

Pika 4 ndryshohet si vijon:

"vepron në kundërshtim me nenin 61 paragrafi (3) të këtij ligji;"

Në pikën 5 fjalet: "paragrafet (1) dhe (3)" zëvendësohen me fjalet: "paragrafi (1)."

Në pikën 11 pas fjalës: "anëtarët" shtohen fjalet: "dhe anëtarëve të pensionuar".

Pika 12 ndryshohet si vijon:

"nuk i dorëzon në Agjenci informatat e cekura në nenin 96 paragrafi (1) të këtij ligji dhe në aktet e përcaktuara nga Agjencia;"

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"1) nuk miraton Kodeks për menaxhim korporativ dhe nuk punon në pajtim me nenin 4 paragrafi (3) të këtij ligji;

2) nuk vendos mekanizma të kontrollit efikas dhe nuk vendos procedura dhe nuk përcakton persona në pajtim me nenin 18-b të këtij ligji;

3) nuk veendos njësi organizuese në pajtim me nenin 21-a paragrafi (1) të këtij ligji;

4) nuk i respekton obligimet nga neni 21-b paragrafet (1), (2), (3) dhe (4) të këtij ligji;

5) nuk vendos aktivitete për menaxhim me rreziqe, nuk emerton person përgjegjës për menaxhim me rreziqe dhe nuk dorëzon raport në pajtim me nenin 21-v paragrafet (1), (2) dhe (5) të këtij ligji;

6) nuk emerton revizor të jashtëm të autorizuar me referenca të mira dhe nuk shpall ekstrakt të raportit të reviduar financiar me mendim të revizorit të autorizuar në pajtim me nenin 22 të këtij ligji;

7) vepron në kundërshtim me nenin 22-b të këtij ligji dhe

8) nuk ka dokument për strategji investuese me përmbajtje në pajtim me nenin 112-a paragrafet (1) dhe (2) të këtij ligji dhe aktet e përcaktuara nga Agjencia."

Neni 67

Në nenin 135 paragrafi (1) pika 1 pas fjalës "paragraf" numri "(5)" zëvendësohet me numrin "(6)".

Pika 3 ndryshohet si vijon:

"Nuk i plotëson obligimet nga neni 63 paragrafi (3) të këtij ligji;"

Pas pikës 5 shtohet pike e re 5-a, si vijon:

"5-a) nuk lidh marrëveshje për kryerjen e punëve të marketingut të fondit të detyrueshem pensional me bashkëpunëtor afarist në pajtim me nenin 76 paragrafi (2) të këtij ligji;" .

Në pikën 6 pas fjalës "anëtarësim" shtohet presje ndërsa fjalet: "ose marrëveshje e perkohshme për anëtarësim" zëvendësohen me fjalet: "marrëveshje për zbatim ose marrëveshje për tërheqje të programuara".

Në pikën 8 pas fjalës "anëtarit" shtohen fjalet: "dhe anëtarit të pensionuar".

Pas pikës 8 shtohet pike e re 9, si vijon:

"9) dorëzon të dhëna për anëtarët dhe për anëtarët e pensionuar në formë në kundërshtim me nenin 95 paragrafi (5) të këtij ligji."

Neni 68

Në nenin 136 paragrafi (1) pika 1-a numri "(6)" zëvendësohet me numrin "(5)".

Pika 5 ndryshohet si vijon:

"vepron në kundërshtim me nenin 118 të këtij ligji."

Neni 69

Në nenin 136-g paragrafi (1) numri „52“ zëvendësohet me fjalet: "(51) paragrafi (7)".

Neni 70

Pas nenit 136-d shtohen dy nene të reja 136-gj dhe 136-e, si vijojne:

"Neni 136-gj

Gjobe me shume prej 4 000 eurosh në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje personit fizik nese si:

- 1) anetar i Keshillit Drejtues, i Keshillit Mbikeqyres dhe person udheheqes në shoqeri nese nuk e ploteson detyren fiduciare nga neni 18-a paragrafi 1 të ketij ligji.
- 2) aktuar nuk u pembahet obligimeve të parapara në nenin 21-b paragrafet (5), (6), (7) dhe (10) të ketij ligji dhe
- 3) person pergjegjes për menaxhim me rreziqe nuk siguron analize objektive të rreziqeve dhe nuk e keshillon drejte keshillin drejtues në pajtim me nenin 21-v paragrafi (3) të ketij ligji.

Neni 136-e

Gjobe me shume prej 40 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje Qendres nese:

- 1) nuk i mundeson qasje në librat, dokumentet dhe evidencen tjetër personit i cili kryen kontroll në emer të Agjencise në pajtim me nenin 53 paragrafin (1) piken g) të ketij ligji dhe
- 2) nuk i menjanon parregullsite ligjore në pajtim me nenin 53 paragrafin (5) të ketij ligji."

Neni 71

Neni 72 nga Ligji për ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit për sigurim pensional të detyrueshem me financim kapital "(Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonise" nr. 88/08) ndryshohet si vijon;

"(1) Deri në ditën e fillimit të pranimit të Ligjit për pagim të pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga sigurimi i detyrueshem pensional me financim kapital, kur anetari i fondit pensional do të fitojë të drejtën e pensionit të moshës sipas Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, mund ta terheq shumën e plote nga llogaria e tij individuale.

(2) Deri në ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit për pagim të pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga sigurimi i detyrueshem pensional me financim kapital, kur anetari i fondit pensional nuk do të fitojë të drejtën e pensionit të moshës sipas Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor për shkak se nuk e ka plotësuar stazhin e pensionit së paku 15 vjet, mund ta terheq shumën e plote nga llogaria e tij individuale."

Neni 72

Në Ligjin për ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit për sigurim të detyrueshem pensional me financim kapital "(Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonise" numer 98/2012), në nenin 1 paragrafi (3) fjalet: "5-a e cila behet pika 5" zevendesohen me numrin "4-a".

Neni 73

Lartesia e kompensimit të kontributeve të nenit 52 paragrafi 1 të ketij ligji me të cilin ndryshohet neni 98 paragrafi (1) pika a) të Ligjit për sigurim të detyrueshem pensional me financim kapital, të cilin e arketojnë shoqerite ose shoqerite për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare zvogelohet çdo vit dhe nuk mund të jete më shume se 3,5% për vitin 2014, 3,25% për vitin 2015, për 3% vitin 2016, 2,75% për vitin 2017, 2,5% për vitin 2018 dhe 2,25% për vitin 2019, nga çdo kontribut të paguar.

Lartesia e kompensimit mujor nga vlera neto e mjeteve nga neni 52 paragrafi 2 i ketij ligji me të cilin ndryshohet neni 98 paragrafi (1) pika b) nga Ligji për sigurim të detyrueshem pensional me financim kapital, të cilin e paguajnë shoqerite për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare zvogelohet çdo vit dhe nuk mund të jete më shume se 0,045% për vitin 2014, 0,04% për vitin 2015, 0,035% për vitin 2016; 0,035% për vitin 2017, dhe 0,035% për vitin 2018.

Duke llogaritur nga 1 qershori 2013 lartesia e kompensimit të kontributeve nga neni 52 paragrafi 1 të ketij ligji me të cilin ndryshohet neni 98 paragrafi (1) pika a) të Ligjit për sigurim të detyrueshem pensional me financim kapital, që e arketojne shoqerite ose shoqerite për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale nga çdo kontribut i paguar nuk mund të jete më shume se 3,75%, ndersa lartesia e kompensimit mujor të vleres së mjeteve neto nga neni 52 paragrafi 2 të ketij ligji me të cilin ndryshohet neni 98 paragrafi (1) pika b) të Ligjit për sigurim të detyrueshem pensional me financim kapital, nuk mund të jete më shume se 0,045%.

Neni 74

Aktet nenligjore të parapara me kete ligj do të miratohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Neni 75

Autorizohet Komisioni Juridik ligjvenes i Kuvendit të Republikes së Maqedonise që të percaktoje tekst të spastruar të Ligjit për sigurim të detyrueshem pensional me financim kapital.

Neni 76

Dispoziatt e nenit 31 të ketij ligji me të cilin ndryshohet neni 61 i Ligjit për sigurim të detyrueshem pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikes së Maqedonise" numer 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113 /2005, 29/2007, 88/2008 , 48/2009, 50/10, 171/10, 36/11 dhe 98/12), do të fillojne të zbatohen nga 1 janari 2014.

Dispozitat e nenit 55 të ketij ligji me të cilin shlyhet neni 102 i Ligjit për sigurim të detyrueshem pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikes së Maqedonise" numer 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113 /2005, 29/2007, 88/2008 , 48/2009, 50/10, 171/10, 36/11 dhe 98/12), do të fillojne të zbatohen nga 1 qershori 2013.

Dispozitat e nenit 58 paragrafi (1) të ketij ligji me të cilin ndryshohet neni 117 paragrafi (1) pika gj) të Ligjit për sigurim të detyrueshem pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikes së Maqedonise" numer 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113 /2005, 29/2007, 88/2008 , 48/2009, 50/10, 171/10, 36/11 dhe 98/12), do të fillojne të zbatohen nga 1 janari 2014.

Dispozitat e nenit 59 të ketij ligji me të cilin ndryshohet neni 118 i Ligjit për sigurim të detyrueshem pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikes së Maqedonise" numer 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113 /2005, 29/2007, 88/2008 , 48/2009, 50/10, 171/10, 36/11 dhe 98/12), do të fillojne të zbatohen nga 1 janari 2014.

Neni 77

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikes së Maqedonise".